

E drejta për t'u informuar

E drejta e informimit dhe kërkesa për informim (ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, nenet 3 dhe 11).

Nëse i referohemi përmbajtjes së nenit 3 dhe 11 të ligjit për të drejtën e informimit kemi parasysh se:

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet, ndërkohë autoriteti publik (UMT) është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
2. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
3. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe depozitohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.
Pasi kërkesa depozitohet në një nga format e lartëpërmendura, regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a. emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
- b. adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
- c. përshkrimin e informacionit që kërkohet;
- d. formatin në të cilin preferohet informacioni;
- e. çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: ___/___/202__ Nënshkrimi:
---------------------------------------	---	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____


Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: ___/___/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejttoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Dëshironi të merrni
një informacion publik?

NDIQNI NËNTË HAPAT E MËPOSHTËM:



FORMAT E DËRGIMIT TË ANKESËS

-  EMAIL: info@idp.al
-  DORAZI
-  POSTË: Rr. e Kavajës, Nd. 80, H1, Tiranë